



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-32981 /22

Klinë, dt: 21.09 /22

PROCESVERBAL

Nga Debatimi me Publikun, mbajtur, më 13.09.2022, me fillim nga ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I DITËS

1. Draft-Buxheti i Komunës së Klinës 2023-2025.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi, ku të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të OJQ-ve, media dhe qytetarë të Komunës së Klinës.

Kryesuesi, z. Fadil Gashi, fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe pastaj fjalën i dha ushtruesit të detyrës së drejtorit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, z. Ajet Sejdiu.

Fadil Gashi, Kryesues: Ne e kemi obligim ligjor që t'i organizojmë këto takime, këto debate bashkë me qytetarë dhe unë po ju njoftoj se 12 takime janë organizuar nëpër fshatra dhe vendbanime të ndryshme. Ky është i 13-ti që po e mbajmë këtu, nuk do të thotë që përfundon prapë edhe pse po i debatojmë këto rreth një dokumenti jashtëzakonisht të rëndësishëm pas Statusit të Komunës që është Kushtetuta për Vetëqeverisje Lokale, është dokumenti më i rëndësishëm për jetën e qytetarëve, për organizimin dhe shtrirjen e investimeve që Komuna i planifikon t'i realizojë për vitin 2023-2025, prandaj ka rëndësinë e vet dhe ne duke u bazuar në

Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në aktet tjera nënligjore, në Rregullativat tona lokale që i kemi ndërtuar, i kemi hartuar dhe aprovuar në këtë Kuvend, ne e kemi organizuar sot këtë dëgjim publik, dhe kemi vetëm një rend të ditës, që është:

Shqyrtimi i draft- buxhetit i Komunës së Klinës për vitin 2023-2025.

Unë fillimisht po i jap fjalën ushtruesit të detyrës së drejtorit për Buxhet dhe Financa, zotëri Ajet Sejdiu, që ta bëjë një prezantim të shkurtër. Secili prej jush që ka vullnet mund ta tërhiqni këtë dokument edhe fizikisht edhe në mënyrë elektronike, kudo që dëshironi gjitha mundësitë i keni edhe me konsultua këtë dokument dhe deri me datën 23 të këtij muaji janë ditë në shërbim të secilit prej jush dhe atyre që po na dëgjojnë duke e falënderuar edhe Radio Alben që e kemi këtu prezent, kanë mundësi prapë me na dhënë propozime, prapë me na dhënë sugjerime, do të thotë deri me datën 23 ne planifikojmë që të miratojmë buxhetin dhe kur miratohet për një vit fiskal, s'ka të drejtë të ankohet më askush. Deri atëherë unë po e kërkoj angazhimin e secilit prej jush dhe po ja kaloj fjalën ushtruesit të detyrës së drejtorit, z. Ajet Sejdiu!

Ajet Sejdiu: Përshëndetje kryetar, përshëndetje drejtorë të nderuar, komandat i policisë, këshilltarë të nderuar që jeni prezent dhe ju qytetarë! Sot, siç e potencoi kryetari i Kuvendit kemi për ta shqyrtuar një draft, një ndër dokumentet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Komunës sonë për periudhën një vjeçare dhe planifikimet për dy vitet e ardhshme, pra për vitin 2024 dhe 2025. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe në përgjithësi Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financa të Pushtetit Lokal dhe Udhëzimet Administrative që i rregullojnë këto lami ju ka përveshur punës menjëherë pas marrjes së qarkores së parë buxhetore 01/2023 sipas Udhëzimit Administrativ për ta informuar komisionin i cili do ta udhëheqë procesin e buxhetit për vitin 2023 dhe planifikimet për vitin 2024 dhe 2025.

Këtë komision e kemi propozuar ne si Drejtori e Financave, pastaj e ka miratuar zyrtari kryesor administrativ kryetarit të Kuvendit të komunës. Ky komision ka pasur për obligim për ta udhëhequr procesin e zhvillimit buxhetor, në këtë komision janë kuadrat më të spikatura të Drejtorisë për Financa në krye me zyrtaren kryesore financiare, zonjën Xufe Kelmendi. E kemi përpiluar buxhetin dhe e kemi dërguar te Bordi Ekzekutiv. Bordi Ekzekutiv e ka aprovuar buxhetin dhe e ka vënë në shqyrtim për dëgjimet publike gjatë kësaj periudhe, pra, është fjala për Kornizën e parë afatmesme-buxhetore për periudhën e parë pas qarkores së parë buxhetore, kemi dal në teren, kemi organizuar dëgjime publike me qytetarët në të gjitha lokalitetet, pra, siç e tha kryetari i Kuvendit, kemi organizuar diku 12 dëgjime publike deri më tani, ky është dëgjimi i 13-të, e kemi vënë draftin në ueb-faqe dhe fizikisht e kanë marrë disa palë të interesuara, tani jemi në fazën përfundimtare të buxhetit. Janë dy karakteristika kryesore që e karakterizojnë këtë buxhet këtë vit: Nën 1 kemi rritje të buxhetit në të gjitha kategoritë buxhetore dhe kemi rritje të hyrave vetanake që janë planifikuar për vitin 2023. Unë po jua potencoj në pika të shkurtra sa është buxheti total dhe sipas kategorive:

Paga dhe mëditje kemi 6 milion e 753 mijë e 688 euro, mallra dhe shërbime kemi 1 milion e 660 mijë euro, komunalit i kemi 200 mijë euro, transferim dhe subvencione kemi 400 mijë euro dhe kapitale kemi 4 milion e 37 mijë e 907 euro, kurse në total buxheti për vitin 2023 është 13 milion e 51 mijë e 595 euro. Pra kemi një rritje prej 8.57% më të lartë sesa në vitin që jemi, kurse të hyrat vetanake i kemi të planifikuara dhe të përcaktuara sipas qarkores buxhetore 1 milion e 373 mijë e 774 euro apo 28.89% pra të hyrat vetanake na janë rritur dhe është një hendikep që për vitin e ardhshëm duhet të angazhohemi tërësisht të gjithë akterët për realizimin e këtij projekti sepse pak i kemi diku përafërsisht 400 mijë euro më shumë sesa në vitin që jemi. Kemi hartuar

dhe projekte, thash, komisioni pas marrjes së pëlqimit nga Bordi Ekzekutiv diku 59 projekte të cilat i kemi potencuar të gjitha dëgjimet publike dhe qytetarët janë të njoftuar për cilat projekte bëhet fjalë. Ndokush nga ju që është i interesuar për projektet ne mund t'ua sigurojmë edhe fizikisht por i keni edhe në ueb-faqe. Tani e tutje siç e potencoi kryetari i Kuvendit, deri me datën 23 prapë pranojmë propozimet e arritura nga qytetarët dhe nga shoqëria civile dhe nga gjithë palët e interesuara. Unë nuk po diskutoj më shumë sepse po jua lë fjalën edhe juve dhe sigurisht edhe kryetari do të kyçet. Kaq, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit i nderuar, falënderoj edhe kryetarin se na është bashkuar në këtë dëgjim publik! Mua s'më mbetet tjetër veç të hap debat për ju që jeni të interesuar, e kemi edhe kryetarin këtu bashkë me ekipin, këta që po i shihni, që kanë me implementuar komplet edhe kanë me u shtrirë për secilin mjedis t'juajin edhe të atyre se s'janë sot këtu bashkë me ne në sallë. Unë po hap debat, kush e dëshiron fjalën urdhëroni, mos hezitoni!

Tunë Dedaj: Përshëndetje për kryetarin e Komunës, prof. Dr. Zenun Elezaj, përshëndetje për ju kryesues, ju drejtorë, komandantin e policisë, mjetet e informimit dhe gjithë të pranishmit! Unë gëzohem që ka rritje të buxhetit prej 8% por më ra në sy te ndarja; rregullimi i lumenjve, që unë s'mund të pajtohem me atë që 200 mijë euro janë të parapara të bëhen në lumin "Klina", ndërsa 80 mijë euro në lumin "Drini i Bardhë". Do të ishte mirë që të ishte e kundërta, se ne e dimë se "Drini i Bardhë" ka shumë nevoja më të mëdha për rregullimin e shtratit sesa lumi "Klina". Ky është propozimi im që kjo të ndryshohet, do të thotë, 200 mijë të shkojnë për rregullimin e shtratit "Drini i Bardhë" dhe 80 mijë të shkojnë për rregullimin e shtratit të lumit "Klina", kaq!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Tunë, dikush tjetër? Kryetar a dëshiron të kyçesh pak?

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju të gjithë që jeni prezent! Lidhur me shqetësimin e Tunës, 150 mijë euro janë të parapara për rregullimin e shtratit të lumit "Klina", sipas profilin që tanimë ka filluar, do të vazhdojë edhe jo më shumë 150 mijë në 2023-tën, ndërsa te "Drini i Bardhë" janë dy kontrata aktive; është një prej 320 e diçka mijë euro që është duke u realizuar tani rregullimi i liqenit akumulues, po një është edhe kontrata që është edhe më e hershme për rregullimin e shtratit të lumit nga ura e "Haxhisë" deri te ura e "Hekurit" që është në implementim e sipër edhe pse kemi vështirësi nga operatori ekonomik e sidomos si pasojë e ngritjes së çmimeve në këtë vit, por që jemi në procedura ndoshta të shkëputjes së kontratës për shkak të neglizhencës së tij. Mirëpo Drejtoria e Urbanizmit do t'i merr masat e nevojshme bashkë me prokurimin edhe po mendoj që ka investime tek "Drini i Bardhë" dhe në vitet e ardhshme jemi përqendruar që t'kemi investime në të gjithë lumenjtë, jo vetëm në lumin "Klina".

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit kryetar, dikush i interesuar? Urdhëro i nderuar!

Nikoll Kqira (fsh. Leskoc): Faleminderit shumë kryetar dhe kryesisë që keni organizuar këto takime shumë domethënëse. Unë desha ta bëjë një pyetje për fshatin Leskoc. A do të ketë investime ose çfarë investimesh do të ketë? Kaq njëherë!

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Realisht për fshatin Leskoc ose Ranoc është një projekt që është firmosur kontrata vitin e kaluar, vazhdon këtë vit, do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm,

është me një vlerë prej 140 mijë euro, por që kontrata totale është gjysmë milion euro kjo që për tre vjet, që nënkupton do të jenë të gjitha rrugicat e asfaltuara në të dy fshatrat, edhe Ranoc edhe Leskoc dhe rruga Zllakuqan-Ranoc-Leskoc do të rinovohet, pastaj kanalizimi do të përfundohet. Me këtë projekt mendojmë që komplet infrastrukturën rrugore edhe kanalizimin ta trajtojmë dhe ta përfundojmë sipas përshkrimit të projektit që është bërë, sigurisht që vazhdojnë përpjekjet për sigurimin e ujit të pijes që është një projekt bashkë me Hidrodrinin që po e bëjmë dhe po mundohemi me marr prej Osejanit, kështu janë angazhimet tona, është një aprovim i Bordit të Hidrodrinit që Bordi Menaxhues e ka aprovuar kërkesën e Komunës, tani vetëm do t'i gjejmë mjetet financiare në bashkëfinancim, faleminderit!

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit Kryetar! Urdhëro, Emin Balaj!

Emin Balaj (fsh. Gllarevë): Përshëndetje kryesues, kemi një shqetësim nga lagja Morina, Veselaj dhe Abazaj, aty ku është i ndërtuar kanalizimi kemi një prishje aty që ka qenë gjatë tërë verës dhe unë kam bërë një kërkesë por nuk kam marr përgjigje, dmth është shumë problem i madh sepse kundërmimi është i jashtëzakonshëm, kështu që e kisha lutur Drejtorinë e Urbanizmit që të vijë, ta shikojë dhe ta rregullojë këtë problem. Edhe një shqetësim tjetër që e pash këtu, te planifikimi buxhetor, ne jemi bukur fshat i madh dhe mu duk ishte përcaktuar 50 mijë euro, mu duk pak si minimal, faleminderit!

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Shqetësimin që e paraqiti Emini është shqetësim që ka ardhur në adresim timin para dy jave ndoshta dhe unë e kam adresuar tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, por që është në kompetencë të kompanisë "Hidrodrini", por ne po bëjmë të pamundurën që me detyru në një formë me ndërhy, në qoftë se jo, atëherë ne duhet me ndërhy ndoshta me ndërrimin e një sekuence të caktuar të kanalizimit, sepse me gjasë kështu po duken problemet. Ndërsa për sa i përket investimeve të vogla, ne jemi dëshmitarë që që pesë vite që jam unë si kryetar i Komunës së Klinës, vazhdimisht kemi investime dhe këtë vit s'kemi pasur po bëjmë rrugica ka 10 metra ka 8 metra, domethënë është mbuluar komplet Gllareva, Rixheva me infrastrukturë edhe rrugore edhe me kanalizim edhe kemi menduar që nuk ka nevojë, po në qoftë se ka tani pas aprovimit të buxhetit që do të bëhet, Drejtoria e Urbanizmit përmes kompanisë projektuese dhe inxhinierëve që i kemi të angazhuar, do të del në terren dhe do të kemi mundësi edhe të tjera, eventualisht në qoftë se sipas kërkesës së qytetarëve paraqiten nevoja më shumë po e kemi vlerësuar dhe ma merr mendja që nuk ka nevojë për mjete buxhetore të dedikuara në këtë fazë. Në qoftë se ka, ne e kemi projektin e impiantit, që jemi në proces të rifillimit, ndërtimit por që është një projekt që nuk ndërlidhet me atë shqetësimin që e pate ti.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit kryetar, dikush tjetër? Po urdhëro, Lekë Beka?

Lekë Beka (fsh. Krushevë e Madhe): Përshëndetje për të gjithë! Kam disa kërkesa rreth fshatit, p.sh., është ndriçimi i fshatit, asfaltimi i rrugicës sonë deri te varrezat dhe kanalet e ujitjes. Pasi që po e shoh në shumë fshatra tjera janë rregulluar, pjesa dërrmuese tek ne që nga viti 2016, 700 metra janë qit kanal ku është një vlerë prej 160 milionë euro që është investuar, aty ujiten veç nja 7-8 hektarë jo më shumë, kështu që kërkoj që në atë drejtim të ndërmerret diçka, dhe e kam një pyetje për kryetarin, kryetari e di në vitin 2020-2021 e ka parë fshatin Krusheva e Madhe të përmbytur, kam bërë kërkesë me shkrim, fizikisht kam qenë te kryetari, fizikisht kemi qenë delegacion te kryetari që nuk ka qenë aty dhe na ka pranuar nënkryetaria, përndryshe

kryetari e ka parë, ne jemi si n'deti, për shkak të kanaleve që kalon nëpërmes fshatit , është i përmbyllur tërësisht, nuk kërkoj as të ma betonojnë as të ma rregullojnë me gurë, vetëm aty ka nevojë një eskavator me e hap për shkak se i ka 50 vite a më shumë që nuk është hapur dhe nuk është punuar në atë jaz. Faleminderit!

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Për sa i përket ndriçimit, kemi pasur vonesë këtë vit sepse kompania që është e kontraktuar si pasojë e problemeve që po e dimë tash, ngritja e çmimeve, jemi në momente të shkëputjes së kontratës mirëpo mos t'them tash me një vit vonesë sepse ne kemi ne planifikimet tona që viti 2022-2023 ka me qenë vit i përfundimit ose i mbulimit komplet të të gjitha fshatrave të Komunës së Klinës me ndriçim por do të jemi me një vit vonesë sepse këtë vit nuk kemi pasur, ndërsa aty ku edhe unë kam qenë dëshmitar i vërshimeve ka nevojë ndoshta në rrugën Zllakuqan-Budisalc me rrit atë urën edhe unë besoj që edhe drejtori i Urbanizmit është këtu. Realisht rrugicën për te varrezat jemi munduar edhe këtë vit por nuk mundëm po për vitin e ardhshëm delegacioni që ka qenë i kemi premtuar që do t'rregullohet ajo, pastaj për kanalet e ujitjes drejtori i Bujqësisë është këtu, ne kemi investime këtë vit, gjysmë milionë euro në kanalet e ujitjes sepse është një projekt i madh që po financohet nga Ministria e Bujqësisë , për fshatin Budisalc por që do të jetë edhe në ndihmë të Krushevës së Madhe, ama bashkërisht me ju edhe me Drejtorinë e Bujqësisë është mirë me evidentu dhe vitin e ardhshëm ka mundësi buxhetore që me i ndërtuar edhe kanalet e ujitjes.

Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit kryetar, dikush tjetër? Po, Kolë Prenaj?

Kolë Prenaj (fsh. Dresnik): Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar dhe gjithë të pranishmit! Këtu me të vërtetë është punuar por ka mundësi që të detalizohen disa gjëra sidomos te linja buxhetore. Te bujqësia këtu po e shoh se janë përzier sidokudo buxhetet, ai i bujqësisë, ai i shërbimeve por edhe ambienti. Unë mendoj se te bujqësia duhet me qenë pak më sy qelë se ne jemi vend bujqësor, vend agrar duke u nisur nga ajo që ka mundësi të subvencionimit nga komuna disa fermerë që nuk marrin subvencione nga Ministria e Bujqësisë, fermerë të vegjël s'po i quajmë se ata janë më të dëmtuar si për parcela të vogla që janë me veprimtari të perimeve, bletëve që s'mund ta arrijnë kriterin për subvencione etj, etj. E në këtë kategori e kisha qit edhe një linjë buxhetore për financimin dhe përkrahjen e fermerëve që janë me kredina dmth me i subvencionu kamatën e kredinave bujqësore që në disa komuna është kjo. Unë e kam cekur edhe në Asamble se mungojnë për ekipin e profesionalistëve me ju ndihmu fermerët për aplikimin e grandeve duke u nisur nga Ministria e Bujqësisë, Komisionit Evropian, Ligjit etj. Kështu që këtu kisha menduar që edhe njëherë le të shqyrtohet mundësia e përkrahjeve në mënyrë direkte të fermerëve, edhe te çdo varrezë me e qu asfaltin dmth rrugicave me i asfaltu edhe mundësisht kompaninë për hapjen e varrezave, nuk di sa keni menduar në këtë drejtim, disa komuna janë si p.sh., Peja, Suhareka, etj, se bukur shumë po ballafaqohen, si kleri katolik ashtu edhe ai mysliman te organizimi i hapjes së varrezave, kështu që kjo mundësi është. Kaq, faleminderit!

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Sivjet, për dallim nga vitet e tjera, janë të ndara, të destinuara 110 mijë euro për subvencione dhe ne kemi menduar që të mbështesim fermerët dhe qytetarët do të vazhdojnë me sera, pastaj të gjithë të interesuarit, grupit të interesit që kanë të bëjnë me investime kam kërkuar nga drejtori i Bujqësisë që t'i takojë dhe t'i marr kërkesat.

Unë kam takuar p.sh., bletarët dhe kam marr kërkesën e tyre, besoj që janë mjete të konsiderueshme ndërsa ajo që e the për mbulimin e kredive ndoshta ne na duhet pak edhe një ekspertizë, na duhet dhe do ta marrim parasysh si një këshillë e mirë që të marrim pak edhe ekspertizë, të shohim edhe përvojën që e kanë komunat tjera, pse jo në qoftë se kemi mundësi për këtë vit besoj që jemi pak vonë sepse mund t'hyj në një projekt të cilit nuk e zotojmë si duhet. Ndërsa ne kemi një vendim të Kuvendit Komunal që i mbulojmë shpenzimet e varrimit me një vlerë prej 170 euro, kjo mund të modifikohet, mund të kalohet ndoshta është edhe rekomandim i Drejtorisë së Financave sepse po kemi probleme se çdonjërin që e mbulojmë po duhet me e regjistrua si furnitor, dmth janë vështirësi edhe në këtë drejtim, mund ta bisedojmë me bashkësitë fetare ndonjë formë por me rëndësi është që ne kemi ndarë shumën dhe e kemi të destinuar edhe në këtë buxhet nga 170 euro për çdo vdekje por edhe për lindje që është 180-200 dhe mbi 250 për lindjen e tretë, dmth një,dy,tre e kështu me radhë.


Fadil Gashi, Kryesues: Faleminderit kryetar,dikush tjetër?

Nikoll Kqira (fsh. Leskoc): Desha ta dijë këto firmat, kompanitë që e bëjnë ndërtimin e rrugëve ose kanalizimeve, a i mbikëqyr dikush p.sh., për dëmet që i bëjnë ose punën që nuk e kryejnë si duhet, se po ka raste që vijnë për shembull punën e tyre e kryejnë mirë por bëjnë tjetër gjë dëm, a ka dikush që i mbikëqyr ose i dënon? Faleminderit!

Prof. Dr. Zenun Elezaj, Kryetar: Komuna realisht çdo kontratë që firmosim unë e autorizoj menaxherin e projekteve dhe menaxherin e kontratës të cilët janë të obliguar që në aspektin financiar dhe në aspektin teknik të përcillet projekti në çdo etapë të zhvillimit dhe në këtë drejtim çdo ankesë që vjen nga qytetarët eventualisht për dëme sigurisht që do të merret parasysh nga kompania, ajo është e obliguar me e sanu po edhe kualiteti i lidhjes mvaret prej këtyre dy personave, unë mendoj që mund të ketë edhe ngapak të meta por që kërkesat tona janë rritje jemi duke e vazhduar tani edhe planin e menaxhimit dmth gjithçka është duke u jemi duke ecur në dobi të kualitetit të projekteve.

Fadil Gashi,Kryesues: Faleminderit kryetar, dikush tjetër? Atëherë unë duke ju falënderuar për prezencë, duke ju përkujtuar edhe njëherë që ende jemi brenda kohës dhe mundësive që mund të pranojmë propozime e sugjerime. Ju falënderoj shumë, mirupafshim në takimet e radhës!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

